

Draft/ 25 Gusht, 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr.____, datë _____ 2018

PËR

RININË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton veprimtarinë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, në kudër të të drejtës të të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të plotësojë kuadrin ligjor e institucional për të rinjtë në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare që adresojnë aspekte të të drejtave dhe fuqizimit të të rinjve dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

- b) të promovojë të drejtat e aktivizmin e të rinjve dhe të krijojë kushte për adresimin e nevojave dhe interesave të të rinjve;
- c) të përmirësojë statusin social dhe pozitën e të rinjve, në mënyrë individuale dhe kolektive;
- d) të rregullojë masat e veprimtaritë e ndërmarra në nivel qendror dhe lokal që kanë për qëllim përmirësimin e pozitës së të rinjve si edhe krijimin e kushteve për adresimin e nevojave dhe interesave të tyre në të gjitha fushat me interes për të rinjtë;
- e) të rrisë rolin e të rinjve në hartimin e politikave në fushat me interes për të rinjtë;

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) të rinjtë me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, të cilët ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) të rinjtë me shtetësi shqiptare, të cilët ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "*Iri/e re*" është çdo person në moshën 15 vjeç deri në 29 vjeç;
2. "*Politikë rinore*" janë veprimtaritë e qëllimshme dhe të qëndrueshme të ndërmarra nga ana e pushtetit qendror e vendor, organizatat rinore e për të rinjtë dhe shoqëria që synojnë krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin personal të të rinjve dhe për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike, sociale, ekonomike dhe kulturore, në nivel lokal dhe kombëtar nëpërmjet veprimtarive që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve në vend.
3. "*Aktorë të politikave rinore*" janë organet, institucionet dhe strukturat, në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësi që prekin të rinjtë e hartojnë politika rinore si dhe aktorë të tjerë që marrin pjesë në procesin e hartimit e zbatimit të politikave rinore;
4. "*Infrastrukturë rinore*" është një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtesë e projektuar dhe planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtari rinore;
5. "*Hapësira rinore të sigurta*" janë ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që i përshtaten nevojave të tyre të shumëllojshme, marrin pjesë në procese vendimmarrëse dhe shprehen lirshëm. Hapësirat rinore të sigurta përfshijnë hapësirat qytetare që i japin mundësi të rinjve të angazhohen në çështjet e qeverisjes; hapësirat publike që i japin mundësi të rinjve të marrin pjesë në veprimtari sportive, kulturore e argëtuese në komunitet; hapësirat digjitale që i ndihmojnë të rinjtë të ndërveprojnë virtualisht me të rinj të tjerë brenda e jashtë vendit; dhe hapësira fizike të projektuara dhe planifikuara për të plotësuar nevojat e shumëllojshme të të rinjve në përgjithësi e sidomos të atyre vulnerabël, të magjinalizuar ose viktimat të dhunës e trafikimit;
6. "*Edukimi jo-formal për të rinjtë*" është çdo veprimtari e organizuar dhe përshtatur për të rinjtë jashtë sistemit formal të arsimimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe

pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënimit nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe akses në tregun e punës;

7. "Dialog i strukturuar" është një dialog i hapur, transparent, afatgjatë, i vazhdueshëm dhe sistematik mes të rinjve dhe organizatave rinore dhe dhe institucioneve në nivel qendror e lokal që mbulojnë çështje të lidhura me të rinjtë;

Neni 5

Parimet

Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) promovimit të të drejtave dhe mbështetjes me qëllim fuqizimin e të rinjve;
- b) legjitimitetit, barazisë në të drejta e mundësi dhe mosdiskriminimit;
- c) koordinimin e politikave rinore me politikën në fushën e arsimit, punësimit, politikave sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, drejtësisë, punëve të brendshme e mbrojtjes;
- d) koordinimin e politikave rinore me politikën e zbatuar nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- e) garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e hartimit të politikave rinore;
- f) lirinë e organizimit të të rinjve, lirinë e inisiativave rinore dhe të vetë-qeverisjes së organizatave rinore;
- g) subsidiaritetit.

KREU II

PËRGJEGJËSITË (KUADRI) INSTITUCIONALE

Neni 6

Sistemi rinor (Kuatrë institucional rinor)

1. Sistemi rinor përbëhet nga institucionet e strukturat, në nivel qendror e vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësi në fushën e të drejtave e mbrojtjes së të rinjve, organizatat rinore, organizatat për të rinjtë dhe të rinjtë individë, që veprojnë në nivel qendror dhe vendor.
2. Roli i këtyre aktorëve përcaktohet nga ky ligj, aktet e tij nënligjore dhe legjislacioni tjetër në fuqi që adreson çështje të caktuara që lidhen me të rinjtë.

Neni 7

Ministria përgjegjëse për rininë

Ministria përgjegjëse për rininë ka këto kompetenca:

- a) harton e propozon bazën ligjore për rininë;
- b) harton politika rinore, planifikon buxhet të përshtatshëm për realizimin e tyre dhe monitoron zbatimin e tyre;
- c) koordinon bashkëpunimin me institucione të tjera qendrore, të cilat janë përgjegjëse për aspekte të veçanta të të rinjve;
- ç) monitoron situatën e të rinjve dhe impaktin e politikave;

- d) projektton dhe ndërton hapësira të sigurta për të rinjtë;
- dh) përfaqëson në organizmat dhe nivelet ndërkombëtarë për çështje që lidhen me rininë dhe përmbush detyrimet e anëtarësimit në programe e projekte ndërkombëtare;
- e) konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, projektet e programet në fushën e rinisë;
- ë) krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave për të rinjtë;

Neni 8

Ministritë e tjera

Ministritë e tjera, përgjegjëse për çështjet e punësimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, kulturës, sportit, drejtësisë, punëve të brendshme e mbrojtjes, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore duhet:

- a) të sigurojnë zbatimin e këtij ligji dhe realizimin në mënyrë efektive të të drejtave të të rinjve;
- b) të mbështesin politikën rinore;
- c) të marrin në konsideratë të drejtën e të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti në procesin e hartimit të politikave sektoriale dhe të parashikojnë buxhete të përshtatshme që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve.

Neni 9

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Bashkitë (Njësitë e vetëqeverisjes vendore), në përputhje me misionin e tyre dhe gjatë ushtrimit të autoritetit me interes publik vendor, duhet:

- a) të sigurojnë zbatimin efektiv të këtij ligji;
- b) të hartojnë plane vendore duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet e politikave rinore vendore në përputhje me dokumentet politikë në fushën e rinisë;
- c) të krijojnë një bord (komitet ose komision) për monitorimin e politikave rinore në nivel vendor dhe propozimin e nismave që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku ato veprojnë;
- ç) të organizojnë dhe koordinojnë veprimtari që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën mbrojtjes dhe fuqizimit të të rinjve;
- d) të zgjedhin shërbime informimi dhe këshillimi për të mbështetur zhvillimin e të rinjve dhe realizojnë ato në mënyrë të përshtatshme me nevojat e të rinjve;
- dh) të përmirësojnë mundësitë kolektive të komunitetit për të angazhuar dhe mbështetur të rinjtë;
- e) të inkurajojnë vullnetarizmin e të rinjve dhe edukimin jo-formal për të zgjeruar njohuritë, eksperiencën e aftësitë e të rinjve për të përvetësuar vlerat e shoqërisë civile, jetesës së shëndetshme, kulturës, artit, sipërmarrjes, shkencës, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë në rrugë e parandalimit të trafikimit dhe krimit;
- ë) të garantojnë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje nëpërmjet ndërtimit e mbajtjes së një dialogu të strukturuar;
- f) të krijojnë infrastrukturë rinore (shtëpitë e klubit e rinisë, biblioteka, terrene sportive) dhe hapësira të sigurta për veprimtari edukative, sportive, sociale, kulturore e mjedisore;
- g) të emërojnë nëpunës vendorë që merren me çështjet e rinisë; (Të krijojnë strukturë administrative???)
- gj) të financojnë projekte e programe rinore;

h) të mbledhin dhe analizojnë të dhëna në lidhje me situatën e të rinjve në territorin e tyre, aktivitetet e zbatuara dhe planifikuara dhe informojnë ministrinë përgjegjëse për çështjet e rinisë, çdo vit, brenda muajit mars për vitin e kaluar.

Neni 10

Shërbimi Kombëtar për Rininë

1. Shërbimi Kombëtar për rininë është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e rinisë që i kryen funksionet e veta administrative në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel vendor nëpërmjet qendrave rinore.

2. Shërbimi Kombëtar për rininë kryen këto funksione:

- a) zbaton këtë ligj, politikat dhe programet për të rinjtë të hartuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e rinisë;
- b) organizon (kontribuon) informimin, konsultimin dhe aksesin e të rinjve dhe publikut në përgjithësi në procesin e hartimit e zbatimit të politikave, programeve e strategjive për rininë;
- c) organizon, administron dhe koordinon programet dhe projektet rinore;
- ç) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për hartimin, bashkërendimin dhe zbatimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive për rininë;
- d) nxit bashkëpunimin me organizma, institucione, donatorë dhe aktorë të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve e veprimtarive për rininë;
- dh) drejton, bashkërendon dhe mbikqyr punën e qendrave rinore;

3. Struktura e Shërbimit Kombëtar për Rininë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Kombëtar për Rininë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Këshilli Kombëtar i Rinisë

1. Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor që krijohet dhe funksionon pranë Ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.

2. Këshilli Kombëtar i Rinisë ka këto funksione:

- a) jep mendime për projekt aktet ligjore e nënligjore dhe dokumentet strategjike për rininë;
- b) propozon masa për arritjen e objektivave në fushën e rinisë;
- c) jep mendime për projekt-buxhetin për rininë;
- d) kontribuon në çështje të tjera që lidhen me politikat e programet rinore.

3. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga Ministri përgjegjës për çështjet e rinisë dhe përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët 5 anëtarë janë nga ministrinë e tjera e institucionet e varësisë (Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit (Agjencia për

punësim dhe Aftësi), 1 përfaqësues nga pushteti lokal (Shoqata e Bashkive) dhe 5 anëtarë nga organizatat rinore dhe për rininë.

4. Kriteret e anëtarësimit dhe modalitetet e punës së Këshillit Kombëtar të Rinisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

PUNA RINORE DHE ORGANIZATAT

Neni 12

Puna rinore

1. Punë rinore është çdo veprimtari ose inisiativë e organizuar që synon angazhimin e të rinjve në programe, projekte e veprimtari të planifikuara, që zhvillojnë dhe adresojnë interesat dhe nevojat e të rinjve.

2. Puna rinore është e bazuar në qasjen individuale dhe vlerësimin e nevojave të veçanta të të rinjve.

Neni 13

Punonjësi rinor

1. Punonjës rinor është personi që ofrojnë shërbimi këshillimi, informimi, mbështetje dhe udhëzime për të rinjtë, duke i ndihmuar ata të përdorin maksimalisht aftësitë dhe mundësitë e tyre në drejtim të zhvillimit të tyre të mëtejshëm personal, emocional, social dhe ekonomik.

2. Puna e punonjëve rinorë përfshin çdo veprimtari në mbështetje të të rinjve përfshirë planifikimin dhe menaxhimin e veprimtarive komunitare, veprimtari edukative dhe këshillime për të rinj me probleme familjare, shëndetësore, sociale, ekonomike, bullizmi e probleme me ligjin.

3. Punonjësit rinorë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë institucioneve publike e qendrave rinore dhe kanë detyrë jo vetëm që të mbështesin dhe orientojnë të rinjtë por edhe të sigurohen që të rinjtë e ndjejnë mbështetjen në situatat personale.

Neni 14

Statusi (titulli) i punonjësit rinor

1. Punonjës rinor është një i rritur që ka kryer trajnime të veçanta për të punuar me të rinj dhe/ose ka eksperiencë profesionale për të punuar me të rinjtë dhe zbtuar veprimtari rinore.

2. Njohja e statusit (Dhënia e titullit) të punonjësit rinor bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë, në bazë të kërkesës së personave të interesuar.

3. Kriteret e përgjithshme dhe veçanta që duhet të plotësojë një person me qëllim që të marrë tillutin "Punonjës Rinor" dhe edhe procedura e kërkimit të titullit rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.

4. Punonjësit rinorë janë pjesë e një regjistri, i cili mirëmbahet e përditësohet nga ministria përgjegjëse për çështjet e rinisë.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e rinisë krijon një program për trajnimin fillestar dhe të vazhduar të punonjësve rinorë, i quajtur "Programi i punonjësve rinorë". Kriteret, rregullat e procedurat për pjesëmarrjen dhe funksionimin e këtij programi miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë (VKM?).

Neni 15

Organizatave rinore

1. Organizatat rinore janë organizata të themeluara dhe regjistruara sipas legjislacionit përkatës në fuqi për organizatat jofitimprurëse (partitë politike??), që kanë qëllim dhe në fushën e veprimtarisë së tyre pjesëmarrjen në nisma e veprimtari rinore e për rininë dhe ku të paktën 70 (50) % i anëtarëve janë të rinj.

2. Zhvillimi i organizatave rinore inkurajohet dhe mbështetet nga programet e projektet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Regjistrimi si organizatë rinore në bazën e të dhënave për rininë bëhet me kërkesë të organizatës. Kriteret e procedurat e regjistrimit si edhe përmbajtja e listës së organizatave rinore rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.

Neni 16

Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore

1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është një organizatë rinore që ka një anëtarësi prej të paktën 500 persona fizikë dhe ushtron veprimtarinë në një territor prej të paktën 30% të bashkive të vendit.

2. Organizatat rinore që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përfshihen në listën e Organizatave Kombëtare Përfaqësuese Rinore.

3. Njohja e një organizate si Organizatë Kombëtare Përfaqësuese Rinore bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë, në bazë të kërkesës të vetë organizatës, dhe është e vlefshme për 3 vjet. Procedurat e njohjes, refuzimit dhe humbjes rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.

4. Lista e Organizatave Kombëtare Përfaqësuese Rinore publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për çështjet e rinisë.

Neni 17

Organizatat për të rinjtë

1. Organizatat për të rinjtë janë organizata jofitimprurëse, të themeluara dhe regjistruara sipas legjislacionit përkatës në fuqi, qëllimi dhe fusha e veprimtarisë të të cilave është e fokusuar ndër të tjera tek të rinjtë, sipas këtij ligji dhe/ose për një periudhë prej të paktën 3 vitesh kanë zbatuar në mënyrë të vazhduar projekte e programe me impakt tek të rinjtë.
2. Regjistrimi si organizatë për të rinjtë në bazën e të dhënave për rininë bëhet me kërkesë të organizatës. Kriteret e procedurat e regjistrimit si edhe përmbajtja e listës së organizatave për të rinjtë rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.

Neni 18

Baza e të dhënave për rininë

1. Ministra përgjegjëse për çështjet e rinisë krijon, mban dhe administron bazën e të dhënave që kanë të bëjnë me të rinjtë, përmbajtja e të cilës publikohet në portalin “Për Rininë” dhe ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.
2. Qëllimi i bazës së të dhënave për rininë është të sigurojë informacion të përditësuar në lidhje me situatën dhe nevojat e të rinjve në vend si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore në nivel qendror dhe lokal.
3. Baza e të dhënave për rininë përmban:
 - a) listën e organizatave rinore dhe organizatave për rininë në vend;
 - b) listën e Organizatave Kombëtare Përfaqësuese Rinore;
 - c) informacion mbi politikat rinore kombëtare, vendore e Evropiane;
 - ç) informacion të përditësuar mbi mundësitë e financimit të projekteve e veprimtarive rinore;
 - d) studime, analiza, vlerësime e vëzhgime në lidhje me situatën e të rinjve e vlerësime të zbatimit të politikave vendore e lokale rinore;
 - dh) informacione e dokumente të tjera me interes për të rinjtë

KREU IV

FINANCIMIT DHE MBËSHTETJA SHITETËRORE

Neni 19

Burimet e financimit

Politikat, programet e veprimtaritë rinore financohen:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) buxhetet vendore;

- c) të ardhura të gjeneruara nga organizatat rinore e organizatat për të rinjtë;
- ç) programe të Bashkimit Evropian dhe programe të tjera ndërkombëtare;
- d) kontributet e donatorëve;
- dh) burime të tjera të ligjshme financimi.

të ardhura të tjera të njohura nga legjislati në fuqi.

Neni 20

Financimi i politikave, programeve e veprimtarive rinore

Financimi e bashkë-financimi i politikave, programeve e veprimtarive rinore planifikohet e realizohet nëpërmjet:

- a) financimit të infrastrukturës rinore;
- b) financimit të organizatave rinore;
- c) anëtarësimit dhe pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare;
- ç) financimit të studimeve, vëzhgimeve dhe analizave;
- d) financimin e të rinjve me arritje të shkëlqyera në sport, art..

Neni 21

Karta rinore

1. Të rinjtë, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, pajisen me kartën rinore, e cila është dokument unik. Me anë të saj, të rinjtë përfitojnë shërbime publike, me çmime të reduktuara.
2. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen e lëshimin e kartës rinore rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rinisë.
3. Masa e reduktimit nga përdorimi i kartës rinore përballohen nga fondet e parashikuara nga Buxheti i Shtetit e buxhetet vendore.
4. Kategoritë e shërbimeve publike të ofruara nga institucionet publike (shtetërore) dhe masa e reduktimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Të rinjtë e pajisur me kartë rinore mund të përfitojnë reduktim të shërbimeve të ofruara prej subjekteve private, sipas marrëveshjeve që ministria përgjegjëse për çështjet e rinisë ka me këto subjekte. Në këto raste pjesa e reduktuar e vlerës së shërbimit nuk mbulohet nga Buxheti i Shtetit apo buxhetet vendore.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrve që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenittë këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e rinisë që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenittë këtij ligji

Neni 23 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYETARI
GRAMOZ RUÇI**

Përse një Ligj për Rininë?

Aktualisht në Shqipëri nuk ka një kuadër ligjor që mbështet të rinjtë si target grup apo që adreson nevojat e tyre. Sot ka ardhur koha dhe nevojat janë shtuar përtë patur një ligj të tillë, cili mbështet të rinjtë. Kjo nevojë prej shumë vitesh me radhë është ngritur si nevojë nga organizatat rinore, të rinjtë në përgjithjësë dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë me të rinjtë.

Megjithëse ka Ministri të tjera por strukturë në vetë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që punojnë dhe ka përgjegjësi për të rinjtë, mungon kordinimi dhe instrumentet e nevojshme për të zbatuar Planin e Veprimit për të Rinjtë 2015-2015.

Në maj të vitit 2015 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 6.5.2015 "**Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020.**" Qëllimi i këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndër sektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse.

Në konsultimet e para që janë bërë me organizatat rinore në fund të vitit 2017 është vënë në dukje mungesa e një ligji të tillë, që ekziston në të gjitha vendt e Ballkanit Perëndimor, madje në shumicën prej tyre është në proces përmirësimi.

Çfarë nevojash adresohen në Ligj?

Nëpërmjet këtij ligji MASR synon që adresojë disa nga çështjet kryesore që kanë të bëjnë me të rinjtë, organizatat rinore, dhe mbështetjen dhe aktivizimin e tyre në rang kombëtar dhe lokal.

Ky ligj do të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë themelore të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatave rinore, punën vullnetare dhe edukimin joformal të të rinjve, si dhe Institucione të tjera të përfshira në zbatimin e politikave rinore dhe kompetencat që rrjedhin prej tyre, në fushën e kësaj politike. **Politika e të Rinjve nënkupton dhe përfshin të gjitha masat dhe aktivitetet e Institucioneve shtetërore në nivel Qendror dhe vendor, organizatave dhe aktorëve të tjerë, të cilët janë përgjegjës për përmirësimin dhe fuqizimin e statusit të të rinjve.**

Më poshtë janë disa nga çështjet kryesore që do të adresohen nëpërmjet ligjit, që gjithsesi mbeten për t'u diskutuar nga ana teknike deri në fund.

- Database i organizatave rinore (rregullore dhe kriteret për të qenë i regjistruar);
- Këshilli Rinor Kombëtar (rregullore, mënyra e funksionimit, objektivat);
- Mbështetja dhe financimi i projekteve të organizatave rinore;
- Statusi i punonjësit rinor;
- Përcaktimi i moshës rinore;
- Pushteti lokal, përgjegjësit dhe obligimet për rininë (struktura, buxheti, plani veprimit);
- Edukimi jo-formal;

- Zyrat Rinore Lokale;
- Shërbimi Kombëtar për Rininë (ridimensionimi);
- Krijimi i një fondi mbështetjeje financiare për Start-Up-et e të rinjve.
- Mbështetja e talenteve të reja kundrejt shpërblimeve, bursave për përmirësimin të aftësive nxënësve dhe studentëve.

Çfarë është bërë deri tani?

Në Periudhën Nëntor-Maj është zhvilluar një punë përgatitëse për të gjetur donatorët e këtij procesi që tashmë janë Olaf Palme që mbështet procesin e konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesit në të gjithë Shqipërinë dhe UNFPA e cila do suportoje gjithë procesin me ekspertizë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë konsultuar disa aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbi nevojën ose kjo të ligjit. Ka patur takime me homologë nga rajoni dhe Europa. Kemi një ekspert kombëtar dhe 1 ndërkombëtar nga UNFPA që po punojnë paralelisht me grupin e punës.

Është ngritur grupi i punës në MASR me specialist nga të gjithë sektorët dhe janë zhvilluar deri më tani disa mbledhje të grupit. Është rënë dakort mbi pikat kryesore që do të adresojmë me këtë ligj

Është zhvilluar që Konferenca e Parë Kombëtare e lancimit të procesit të konsultimeve për Ligjin e Rinisë.

Ndërkohë ekspertja kombëtare e kontraktuar po kryen një studim mbi gjithë bazën ligjore ekzistuese deri më tani që prek të rinjtë, dhe që është e shpërndarë në institucione të ndryshme.

Ka nisur studimi i legjisllacioneve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe legjisllacionit europian tek i cili kemi më shumë prirje të bazohemi. Janë hedhur në diskutim objektivat dhe po punohet.

Wshw krijuar njw draft paraprak i cili wshw nw diskutime pwr pwr mirsim.

Çfarë do të bëhet deri në përfundim të draftit?

Përgatitja e një ligji për rininë, synon të përfshijë të gjithë grupet e interesit në procesin e konsultimit, duke pasur në thelb domosdoshmërinë e identifikimit të nevojave, kërkesave dhe sugjerimet e të rinjtë si përfituesit kryesor të këtij ligji. Takimet konsultative do të zhvillohen në 12 qarqet e Shqipërisë me pjesëmarrjen e përfaqësues të pushtetit vendor, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të tjerë të Institucioneve të Administratës Shtetërore në nivel qendror dhe Vendor.

Pas përfundimit të procesit të konsultimeve grupi i punës së bashku me ekspertët të gjitha mendimet dhe sugjerimet do t'i analizojë për t'i përfshirë në projekt-ligj. Gjithashtu do të organizohet edhe një tryezë rajonale diskutimi me venedet e Ballkanit Perëndimor ku do të merret eksperiencia e këtyrevendeve si Serbia, Kosova, Bosnje-Hercegovina, Mali I Zi dhe Maqedonia, të cilët e kanë tashmë një ligj të tillë.

Pas kësaj do të ketë një konsultim me të gjitha institucionet e tjera në rang qendror dhe vendor për të patur mendimin e tyre. Megjithëse përfshirja e tyre është menduar që në fazë të hershme të përgatitjes së ligjit për ta patur mendimin e tyre që në fillim.

Gjithashtu do të ketë konsultime edhe me Këshillin e Europës dhe Komisionin Europian për ta përshtaur këtë projekt-ligj me rekomandimet dhe direktivat e tyre.